



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 02.05.2023

Nr: 72

Ora: 14:15

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS NR. 16, DATË 26.04.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË
ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 02.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) ndaj: zj. Ornela Bena, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Prefekturën e Qarkut Korçë; z. Mustafa Çarçiu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Belsh; z. Nertil Nebiaj, person përgjegjës për raportimin e



veprimtarive publike në bashkinë Gjirokastrë si dhe z. Erion Lalaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kavajë.

BAZË LIGJORE:

Neni 19, pika 1, shkronja “c” dhe neni 21, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në kuadër të procedurave për mbikëqyrjen e procesit të raportimeve për veprimtaritë publike të institucioneve shtetërore, ka konstatuar se 4 (katër) institucione publike, konkretisht: Prefektura e Qarkut Korçë, bashkia Belsh, bashkia Gjirokastrë dhe bashkia Kavajë nuk kanë raportuar disa veprimtari publike në ndërfaqen e KQZ-së, duke kryer shkelje administrative të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë indicie, të administruara me disa denoncime me nr. ID unike për secilin institucion.
2. Mbi këtë bazë, Komisioneri ka nisur hetimin administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në katër institucionet shtetërore objekt ankimi. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri ka arritur në konkluzionin se aktivitetet e kryera nga institucionet e mësipërme, referuar pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, përbëjnë veprimtari publike dhe personat përgjegjës në institucionet e mësipërme mbartin detyrimin për raportimin e tyre në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Komisioneri ka vënë në lëvizje KAS-in me anë të një kërkesë, duke kërkuar marrjen e masës administrative me gjobë ndaj personave përgjegjës përkatës për raportimin e veprimtarive publike të Prefekturës Korçë, bashkisë Belsh, bashkisë Gjirokastrë, si dhe bashkisë Kavajë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, sikurse parashikohet nga dispozita e nenit 171 pika 1 e Kodit Zgjedhor.

4. KAS-i caktoi me short z. Elvis Çefa relator për shqyrtimin e kërkesës nr. 16, datë 26.04.2023 të Komisionerit dhe në seancën paraprake vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës, duke e caktuar seancën e shqyrtimit më 02.05.2023, ora 13:30.
5. Seanca e datës 02.05.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të specialistëve të administratës së KQZ-së. Personat përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Prefekturës Korçë, bashkisë Belsh, bashkisë Gjirokastrë, si dhe bashkisë Kavajë të njoftuar rregullisht, nuk u paraqitën në seancën e shqyrtimit.
6. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
 - Kërkesën nr. 16, datë 26.04.2023 të Komisionerit;
 - Vendimin e Komisionerit nr. 410, datë 25.04.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve për raportimin e veprimtarive publike”;
 - Denoncimet nr. 243 ID dhe nr. 250 ID për Prefekturën e Qarkut Korçë;
 - Denoncimet nr. 258 ID, nr. 259 ID dhe nr. 260 ID për bashkinë Belsh;
 - Denoncimet nr. 264 ID, nr. 265 ID, nr. 266 ID dhe nr. 267 ID për bashkinë Gjirokastrë;
 - Denoncimet nr. 269 ID dhe nr. 270 ID për bashkinë Kavajë;
 - Raporte monitorimi të fushatës zgjedhore
 - Emaillet e dërguara me lëndë “Kërkesë për informacion” nga adresa e KQZ-së drejt personave përgjegjës të institucioneve përkatës.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstaton:

1. Shkeljet e konstatuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, për të cilat kërkon sanksion administrativ kanë në fokus zhvillimin e veprimtarive publike, të cilat nuk janë raportuar në ndërfaqen e KQZ-së.

2. Referuar nenit 92, pikës 1 të Kodit Zgjedhor, *“Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. **Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre**”.*
3. KAS vleron se mungesa e interesit të personave të mësipërm për të qenë pjesë aktive e procesit administrative dhe për të dhënë shpjegimet apo prapësimet e tyre lidhur me konstatimet e Komisionerit nuk përbën pengesë për vijimin e shqyrtimit të propozimeve të KSHZ.
4. Nga provat e administruara në hetimin administrativ të kryer nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, për sa i përket Prefekturës Korçë rezulton se aktiviteti i kryer (denoncimi nr. 250 ID) është veprimtari publike, pasi ishte i hapur dhe kishte pjesëmarrje të publikut (studentët e universitetit “Fan Noli”).
5. Tre veprimtaritë publike të bashkisë Belsh me tematikë të supozuar “Takim me banorët”, të paraportuara në KQZ, por të bëra të njohura me anë të denoncimeve me nr. ID 258, 259 dhe 260 që përmbajnë prova të formatit fotografi ku vërehet një numër banorësh dhe prezenca e kryetarit të bashkisë Belsh.
6. Rezulton e provuar se bashkia Gjirokastrë ka organizuar katër veprimtari publike, të bëra të njohura me anë të denoncimeve me nr. ID 264, 265, 266 dhe 267, ku dallohen postimet në rrjetin social “Facebook” në faqen e kryetarit të bashkisë Gjirokastrë. Në këto aktivitete identifikohet prezenca e kryetarit të bashkisë dhe një numri të konsiderueshëm banorësh.
7. Po ashtu edhe rastet e konstatuara në bashkinë Kavajë sipas denoncimeve me nr. ID 269 dhe 270, përbëjnë gjithashtu veprimtari tipike publike referuar pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor që mbartin detyrimin për raportim në KQZ, megjithëse personi përgjegjës për

raportim i bashkisë Kavajë z. Lalaj ka depozituar nëpërmjet adresës së postës elektronike, një e-mail ku shprehet se ai nuk ka dijeni mbi këto dy aktivitete.

8. KAS konstatoi të drejtë konkluzionin e KSHZ se në rastet e msipëme megjithëse jemi përpara veprimtarive publike për të cilat institucioni organizator ka detyrimin për ti deklaruar, personat përgjegjës për raportimin e tyre në institucionet në fjalë, nuk kanë bërë raportim.
9. Këto mosveprime të personave përgjegjës të ngarkuar për raportimin e veprimtarive publike, i ngarkojnë ata me përgjegjësi administrative, në kuptim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, si dhe të pikës 4, të nenit 4 dhe pikës 1, të nenit 10, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Më konkretisht, pika 1, e nenit 10 të këtij vendimi parashikon se *“1. Në rastet kur subjektet e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të këtij vendimi, nuk raportojnë, raportojnë pjesërisht ose zhvillojnë veprimtarinë, pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohen nga Komisionieri Shtetëror i Zgjedhjeve me gjobë nga 3000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.*
10. Komisioneri ka hetuar dhe ka identifikuar drejt përgjegjësinë e zj. Ornela Bena, z. Mustafa Çarçiu, z. Nertil Nebiaj dhe z. Erjon Lalaj, referuar nenit 92, pika 3 të Kodit Zgjedhor, ***“Raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv). Raportimi duhet të kryhet jo më vonë se pesë ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.”***
11. KAS vlerëson se masa administrative e propozuar ndaj personave në fjalë nuk mund të jetë e njëjtë për të gjithë. Ajo duhet të diferencohet në varësi të gravitetit të shkeljeve të kryera dhe duhet të jetë në përpjestim të drejtë me numrin e rasteve të aktiviteteve të raportuara për secilin institucion.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja 'dh', të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës nr. 16, datë 26.4.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksioneve administrative.
2. Vendosjen e sanksionit administrativ gjorbë në masën 5 000 (pesë mijë) Lekë ndaj zj. Ornela Bena, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Prefekturën e Qarkut Korçë, bazuar në nenin 171, pika 1, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar"
3. Vendosjen e sanksionit administrativ gjorbë në masën 7 000 (shtatë mijë) Lekë, ndaj z. Mustafa Çarçiu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Belsh, bazuar në nenin 171, pika 1, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar".
4. Vendosjen e sanksionit administrativ gjorbë në masën 10 000 (dhjetë mijë) Lekë, ndaj z. Nertil Nebiaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Gjirokastër, bazuar në nenin 171, pika 1, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar".
5. Vendosjen e sanksionit administrativ gjorbë në masën 5 000 (pesë mijë) Lekë ndaj z. Erion Lalaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kavajë, bazuar në nenin 171, pika 1, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar".

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Elvis **ÇEFA** - **Relator**

Elvin **LAKO** - **Anëtar**

Ilirjan **RUSMALI** - **Anëtar**

Ledio **BRAHO** - **Anëtar**